



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 17 dhjetor 2021
Kodi i ZRRE-së V_1468_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e nenit 9, neni 16 par. 1 nënpar. 1.4 dhe 1.10, nenin 25, nenin 26 par. 1 nënpar. 1.2, neni 55 par. 1, nënpar. 1.5, nenin 56 par. 1 nënpar. 1.2, dhe nenit 57 par. 2, 7, 8 dhe 9 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë 05/L-084,
- Dispozitat e nenit 22 par. 5 të Ligjit për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085,
- Dispozitat e nenit 25 par. 5 të Procedurës për Tregtimin e Energjisë Elektrike,
- Dispozitat e nenit 3 par. 2 nënpar. 2.1, 2.3 dhe 2.4, par. 3 nënpar. 3.4 nenin 4 par. 3, nenin 5 par. 1 dhe 2, nenin 6 par. 1 dhe nenin 9 par. 2 të Rregullës Nr. 06/2017 për Masat Administrative dhe Gjobat,
- Dispozitat e nenit 23 të Licencës për Prodhim të Energjisë Elektrike të lëshuar Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenc" SH.A.(HC UJMANI),
- Njoftimin Nr. 516/21 të datës 18 tetor 2021 lidhur me shkeljet e konstatuara në lidhje me Vazhdimin e Kontratës për Shitjen e energjisë elektrike nga Ndërmarrja Hidroekonomike „Ibër Lepenc“ Sh.A. (HC „Ujmani“),
- Përgjigjet nga Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenc" SH.A.(HC UJMANI) të pranuar me datë 01.11.2021 nr. prot. 487/2021,

në seancën e mbajtur me 17 dhjetor 2021 ka nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. ISHQIPTOHET - DENIMI ME GJOBË** Ndërmarrjes Hidroekonomike "Ibër Lepenc" SH.A. (HC UJMANI), për shkak të shkeljeve ligjore të konstatuara në lidhje me vazhdimin e Kontratës për shitjen e energjisë elektrike në kundërshtim me Procedurën për Tregtimin e Energjisë Elektrike, në shumën prej **110,705.00 €** (njëqind e dhjetëmijë e shtatëqind e pesë Euro).
- II. OBLIGOHET** - Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenc" SH.A.(HC UJMANI), që brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi të paguajë gjobën në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Kosovës, në shumën e përcaktuar si në pikën I. të dispozitivit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.



ARSYETIM

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) në përputhje me kompetencat e dhëna me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, ka bërë monitorimin e shitblerjes së energjisë elektrike, përkatësisht amandamentimin e vazhdimit të kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike, në mes NH „Ibër Lepenci“ SH.A. (HC „Ujmani“) dhe Fututre Energy Trading and Exchange Dynamics“ sh.p.k.
- ZRRE në kuadër të monitorimit me datë 04.05.2020 përmes email-it zyrtar ka kërkuar nga NH „Ibër Lepenci“ SH.A. (HC „Ujmani“) që të njoftohet për veprimet që kanë ndërmarrë, apo do të ndërmerr kjo kompani, lidhur me prokurimin e energjisë elektrike për periudhën pas skadimit të Marrëveshjes aktuale për shitblerje të energjisë elektrike e cila ka pasur të skadojë me datë 16.05.2020.
- ZRRE me datë 06.05.2020 ka pranuar një përgjigja nga NH „Ibër Lepenci“ SH.A. (HC „Ujmani“), ku ka njoftuar se gjatë vitit të kaluar kanë ndjekur procedurat e parapara me procedurën mbi shitblerjen e energjisë elektrike duke organizuar një ankand, dhe si rezultat kanë nënshkruar kontratën duke u bazuar në formatin e EFET të kontratave, ku kanë theksuar se sasia e kontraktuar për tu liferuar është cekur në kontratë. Po ashtu kanë theksuar se sipas nenit 8 të kontratës kanë pasur për obligim të bëjnë liferimin e sasisë së energjisë, ndërsa si pasoj e kushteve hidrologjike që kanë mbizotëruar në atë periudhë, niveli i ujit në Liqenin e Ujmanit, gjendjes së krijuar si pasoj edhe COVID 19, ruajtjes së ujit për shkak të thatësirave të vazhdueshme nuk kanë pasur mundësi të prodhojnë sasinë e kontraktuar, dhe për arsyet e cekura më lartë në mënyrë që mos të paralizohen si kompani, pasi që dëmi financiar mund të jetë i madhe, në konsultim me ekspertët e brendshëm të kompanisë, kanë theksuar se do të vazhdojnë konform ligjeve dhe obligimeve që prodhon kontrata EFET.
- Me datë 12.05.2020 me kërkesë të NH „Ibër Lepenci“ SH.A. (HC „Ujmani“), është mbajtur takim në ZRRE, ku me ç’ rast ZRRE u njoftua se HC „Ujmani“ ende nuk ka zhvilluar aktivitete lidhur me procesin e prokurimit të energjisë elektrike për periudhën pas datës 16.05.2020. Gjithashtu në atë takim përfaqësuesit e HC „Ujmani“ kanë shprehur qëndrimin se janë duke shqyrtuar mundësinë për vazhdimin e Marrëveshjes ekzistuese, duke e arsyetuar me mos përmbushjen e obligimeve kontraktuale sa i përket liferimit të energjisë elektrike.
- Në atë takim, përfaqësuesve të NH „Ibër Lepenci“ SH.A. (HC „Ujmani“), ju është bërë e qartë se në të gjitha rastet, prokurimi i energjisë elektrike duhet të bëhet në përputhje me Procedurën për tregtimin e energjisë elektrike, dhe për të gjitha aktivitetet e ndërmarra lidhur me këtë proces, ZRRE duhet të jetë e informuar me kohë.
- ZRRE me datë 29 maj 2020 përmes emailit zyrtar ka kërkuar nga NH „Ibër Lepenci“ SH.A. (HC „Ujmani“), se edhe përkundër se ju është bërë e qartë se raportimi në ZRRE nga ana e të licencuarit është obligim ligjor i përcaktuar me legjislacionin primar, sekondar dhe Licencës të lëshuar nga ZRRE, ku gjithashtu është theksuar se pavarësisht se ka kaluar kohë e konsiderueshme nga takimi i fundit i mbajtur në ZRRE, si dhe duke pasur parasysh skadimin e kontratës paraprake për shitblerja



- të energjisë elektrike, ZRRE ende nuk ka pranuar njoftim lidhur me çështjet e prokurimet të energjisë elektrike nga i Licencuari NH „Ibër Lepenci“ SH.A. (HC „Ujmani“).
- o Po ashtu është kërkuar që më së largu deri me 02.06.2020 të informohet ZRRE lidhur me shitjen e energjisë elektrike pas datës 15.05.2020 duke i dërguar të gjitha dokumentet përkatëse rreth prokurimet të kësaj energjie.
 - o ZRRE me datë 02.06.2020 ka pranuar një përgjigje përmes emailit zyrtar nga NH „Ibër Lepenci“ SH.A. (HC „Ujmani“), ku është njoftuar në lidhje me vazhdimin e kontratës, dhe po ashtu ka pranuar edhe vazhdimin amendamentin e kontratës.
 - o ZRRE pas vlerësimit dhe analizimit të vazhdimin amendamentin e kontratës ka vërtetuar faktin se NH „Ibër Lepenci“ SH.A. (HC „Ujmani“), me datë 15.05.2020 kishte nënshkruar vazhdimin amendamentin e kontratës me kompaninë Future Energy Trading and Exchange Dynamics sh.p.k, edhe për gjashtë (6) muaj, gjegjësisht deri me 31 dhjetor 2020, në kundërshtim me Procedurën për tregtimin e energjisë elektrike në fuqi.
 - o ZRRE në vazhdimësi të procesit të monitorimit të vazhdimin të kontratës nga i Licencuara NH „Ibër Lepenci“ SH.A. (HC „Ujmani“), ka përgatitur Raport mbi të gjeturat të cilat janë prezantuar në Bord ZRRE-së, për shqyrtim dhe procedim të mëtutjeshëm.
 - o Bordi i ZRRE-së, në mbledhjen e mbajtur më datë 14.10.2020, ka shqyrtuar të gjeturat në Raportin e për vazhdimin e kontratës për shitjen e energjisë elektrike të përgatitur nga ekspertët e ZRRE-së, dhe më datë 15.10.2020, përmes shkresës zyrtare nr. 359/20 ka dërguar dokumentin *Raporti i Monitorimit për NH “Ibër Lepenc” sh.a. (HC “Ujmani”)*, ku ka njoftuar të Licencuarin lidhur me të gjeturat e monitorimit të vazhdimin të kontratës “Amendament i Kontratës Nr. 01-954-EFET”. Po ashtu, është kërkuar që, bazuar në Nenin 7 par. 2 të Rregullës Nr. 06/2017 për Masat Administrative dhe Gjobat, dhe ka kërkuar nga NH “Ibër Lepenc” sh.a. (HC “Ujmani”) që në afat prej 15 ditë kalendarike të ofroj përgjigjet me shkrim lidhur me të gjeturat në raport.
 - o ZRRE më datë 02.11.2020 nga NH “Ibër Lepenc” sh.a. (HC “Ujmani”), ka pranuar Komentet në Raportin e Monitorimit për NH “Ibër Lepenc” sh.a. të datës 15.10.2020, duke i paraqitur përgjigjet lidhur me të gjeturat në raport, që kanë të bëjnë me vazhdimin e afatit të kontratës deri më datë 31.12.2020.
 - o Bordi i ZRRE-së me datë 07.10.2021 pas shqyrtimit dhe vlerësimit të përgjigjeve/komenteve të NH “Ibër Lepenc” sh.a. (HC Ujmani), lidhur me vazhdimin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike, ka konstatuar se NH “Ibër Lepenc” sh.a. (HC Ujmani), në asnjë rast dhe me asnjë fakt nuk ka mundur të kundërshtoi/argumentoj të gjeturat përmes Raportit të Monitorimit, ka nxjerr Njoftim lidhur me shkeljet e konstatuara në lidhje me Vazhdimin e Kontratës për Shitjen e energjisë elektrike nga NH “Ibër Lepenc” sh.a. (HC Ujmani).
 - o Shkeljet e konstatuara janë: Kontrata fillestare mes NH “Ibër Lepenc” sh.a. (HC Ujmani), dhe „Future Energy Trading and Exchange Dynamics“ sh.p.k. ka pasur afat vlefshmërie nga 17.05.2019 deri 16.05.2020 dhe afati i liferimit deri më 31.12.2020 është vazhduar vetëm për arsye të mos-përmbushjes së obligimeve kontraktuale mes palëve dhe më këtë rast nuk është respektuar Procedura për Tregtim të Energjisë e nxjerr nga Bordi i ZRRE-së në pajtim me Ligjin për Energjinë Elektrike; HC „Ujmani“ nuk ka argumentuar me asnjë fakt relevant se vazhdimi i afatit të kontratës



ka qenë konform kërkesave ligjore, por kryesisht është bazuar në situatën e krijuar me COVID 19, reshjet e ulëta atmosferike jashtë parashikimeve, vështirësitë në parashikimin e prodhimit si dhe vendndodhjen e hidrocentralit në pjesën veriore të vendit; dhe Procesi i prokurimit të energjisë elektrike në Kosovë është i përjashtuar nga Ligji i Prokurimit publik, dhe për këtë arsye, legjislacioni primar ka parashikuar që të krijohet bazë e veçantë ligjore e cila e trajton tregtimin e energjisë elektrike në Kosovë, siç është dokumenti Procedura e Tregtimit të Energjisë Elektrike, prandaj ky proces nuk i nënshtrohet vendimeve të KRPP-së.

- ZRRE në përputhje me dispozitat e nenit 57 paragrafi 7 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Njoftimi i cekur më lartë i është dërguar me datë 18.10.2021 NH "Ibër Lepenc" sh.a. (HC Ujmani) në mënyrë që të mundësohet përgjigja me shkrim lidhur me shkeljet e bëra.
- ZRRE me datë 01 11. 2021 ka pranuar përgjigjet e NH "Ibër Lepenc" sh.a. (HC Ujmani), në lidhje me shkeljet e konstatuara me Njoftimin e cekur më lartë, ku janë paraqitur në formë të shkruar arsyetimet në lidhje me shkeljet e konstatuara nga ZRRE, si dhe arsyetime tjera jashtë atyre të konstatuara përmes Njoftimit të ZRRE-së.
- Bordi i ZRRE, në mbledhjen e mbajtur me datë 17.12.2021, ka bërë vlerësimin dhe analizimin e përgjigjeve të paraqitura nga NH "Ibër Lepenc" sh.a. (HC Ujmani), dhe ka ardhur në përfundim se përgjigjet e NH "Ibër Lepenc" sh.a. (HC Ujmani), nuk i kontestojnë shkeljet e evidentuara nga ana e ZRRE-së, por i njëjti duke dashur t'u shmanget përgjegjësi dhe shkeljeve të konstatuara është thirrur në dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative gjegjësisht në nenin 98 tek afatet e përfundimit të procedurës administrative ku citon se: "procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të duhej të përfundoj sa më shpejt që është e mundur, por jo më vonë se afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure", e që kjo ka të bëjmë në lidhshmëri me nenin 99 dhe 100 që trajton miratimin në heshtje të një akti administrativ i cili është kërkuar nga pala (kërkuesi) përmes kërkesës, e ku Institucionet detyrohen që të veprojnë me kohë dhe të përgjigjet për aktin e miratuar në heshtje, e jo për çështjet e ngritura nga ZRRE përmes procesit të Monitorimit të të Licencuarit i cili është proces i nisur dhe zhvilluar në pajtim me procedurat ligjore për rastin në fjalë.
- Bordi ZRRE-së, me rastin e nxjerrjes së këtij vendimi, ka vlerësuar drejt këtë çështje procedurale në rastin e shqiptimit të masës administrative dhe gjobës, për faktin se në kuadër të përgjegjësi të ZRRE, ka zhvilluar monitorim të bazuar në ligj, Procedurën për Tregtimin e Energjisë dhe Licencën e NH "Ibër Lepenc" sh.a. (HC Ujmani), dhe procesi i vlerësimit dhe monitorimit është proces i cili nuk është i lidhur as në afat e as në kushte por, është një proces i cili zhvillohet dhe vlerësohet deri në përfundimin të tërë procesit, për të arritur të gjendja materiale për të vërtetuar drejt gjendjen faktike, për vërtetimin e drejtë të kësaj çështje në lidhje me veprimet e të Licencuarit, prandaj pretendimet e NH "Ibër Lepenc" sh.a. (HC Ujmani), për sa u përket afateve të trajtimit nuk qëndrojnë, dhe nuk kanë as lidhshmëri logjike e as juridike, pasi që procesi i monitorimit është proces i cili zhvillohet gjatë gjithë kohës, e për të cilën edhe i Licencuari ka qenë në dijeni edhe me kushtet e Licencës të lëshuar nga ZRRE.
- Bordi i ZRRE po ashtu ka trajtuar edhe me shumë kujdes edhe çështjet tjera të cekura në përgjigjet e NH "Ibër Lepenc" sh.a. (HC Ujmani), të cilat nuk janë relevante, pasi që konstatimet e vërtetuara nga ZRRE në asnjë rast dhe me asnjë fakt nuk ka mundur të kundërshtoi/argumentoj të gjeturat



përmes Raportit të Monitorimit, por i njëjti vetëm ka bërë një përshkrim të ligjeve dhe dispozitave ligjore, po ashtu edhe të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku rregullohen marrëdhëniet mes palëve kontraktuese detyrat dhe përgjegjësit e tyre gjatë afatit të kontratave, e për të cilat në asnjë rast të vetëm ZRRE nuk i ka kontestuar, por çështje e shkeljeve ligjore nga ana e NH "Ibër Lepenc" sh.a. (HC Ujmani), është vet vazhdimi i Kontratës, duke mos respektuar Procedurën e tregtimit të energjisë elektrike, por vetëm për arsye të mos-përmbushjes së obligimeve kontraktuale sipas kontratës fillestare mes palëve, dhe duke mos respektuar as institucionin që e monitoron, dhe më këtë rast i njëjti ka vepruar në kundërshtim të plotë me Procedura për Tregtim të Energjisë të nxjerr nga Bordi i ZRRE-së, dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi.

- Bordi i ZRRE-së me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë ka marr parasysh edhe rrethanat lehtësuese duke pasuar parasysh sjellën paraprake, situatën financiare të të licencuarit të ndikuar edhe nga pandemia me COVID 19 si dhe veprimet e të licencuarit të përmendura më lartë. ZRRE gjithashtu ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese edhe sjelljen dhe bashkëpunimin e NH "Ibër Lepenc" sh.a. (HC Ujmani) me ZRRE-në gjatë tërë këtij procesi.
- Bordi i ZRRE-së, po ashtu me rastin e shqiptimit të gjobës administrative ka vlerësuar edhe rrethanat rënduese, për faktin se qëllimi i këtij dënimi nuk është dëmtimi i ndërmarrjes, por përmirësimi i saj, që në veprimet e ardhshme në të mirë të sigurisë juridike të vetë të Licencuarit që të respektohen kushtet e Licencës dhe kërkesat ligjore të obligueshme në fuqi dhe të zbatueshme.
- Gjoha është vlerësuar në shumën prej 5 % vetëm për pjesën e energjisë elektrike të realizuar për vitin paraprak, të vlerësuar nga të dhënat e Pasqyrave Financiare të NH "Ibër Lepenc" sh.a. (HC Ujmani) për vitin 2020, e ku bazuar në këto të dhëna 5% i gjithsej të hyrave nga aktivitetet e shitjes së energjisë elektrike për vitin 2020, ka rezultuar në shumën si në dispozitivin nën pikën I. të këtij Vendimi.
- Vendimi mbi shqiptimin e gjobës është marr konform dispozitave ligjore të nenit 57 paragrafi 2 nënparagrafet 2.2 dhe 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, dhe dispozitat e nenit 9 paragrafi 1.2 dhe 1.14 lidhur me par. 2 të Rregullës Nr. 06/2017 për Masat Administrative dhe Gjobat, të nxjerr nga ZRRE.
- Vendimi për pagesën e gjobës është marr konform dispozitave ligjore të nenit 57 paragrafi 9 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.




Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodhë e fundit.


Bordji ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, kryesues


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar


Lutfije Dervishi, anëtare


Gani Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Arkivit të ZRRE-së